


<b>Për:</b>	<b>Operatorë Ekonomik: "Sinjalizimi" SH.P.K. me adresë në Suharekë</b>  <b>Operatorëve Ekonomik</b>  <b>Të gjitha palëve të interesuar</b>
<b>Nga:</b>	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
<b>Lënda:</b>	<b>VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës</b>
<b>Datë:</b>	<b>01.04.2022</b>

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **31.03.2022**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **"Sinjalizimi" SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL I RRUGËVE**, me Numër të prokurimit: **623-22-1304-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-001-5-2-1**, nxjerr:

#### VENDIM

- I. **APROVOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **"Sinjalizimi" SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL I RRUGËVE**, me Numër të prokurimit: **623-22-1304-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-001-5-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **02.03.2022**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave, pika II. *Kurdo qe miratimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti Kontraktues do te beje publikimin e Njoftimit për korrigjim te gabimeve, duke përdorur formularin B54.*
- III. **Vërejtje:** Komuna do të bëjë korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara sipas Ligjit të Prokurimit Publik për **Pretendimet ankimore qe janë pjesërisht të bazuar.**
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## ARSYETIM

Operatori Ekonomik: "Sinjalizimi" SH.P.K. me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL I RRUGËVE**, me Numër të prokurimit: 623-22-1304-5-2-1, Numër i brendshëm: 623-22-001-5-2-1, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: 02.03.2022, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 31.03.2022, sipas nennit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

### **SEKSIONI II. FLETA E TË DHËNAVE TË TENDERIT (FDT):**

**Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (9.1 & 9.2):**

**Në Vend të:**

**Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet të ketë në listën të paktën këtë staf profesional:**

**2.3. Ekspert i Licencuar për siguri dhe shëndet në punë në profilin e Komunikacionit, i Licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.**

**Dëshmia 2: Licenca e Noterizuar për pikën 2.3.**

**Me formular B54 Korrigjohet në:**

*Ne bazë të Konsultimeve me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, kërkesa juaj Aprovohet e bazuar dhe kriteri:*

**2.3. Ekspert i Licencuar për siguri dhe shëndet në punë në profilin e Komunikacionit, i Licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.**

**Për këtë aktivitet të prokurimit nuk do të zbatohet (do të tërhiqet) Kërkesa e më sipërme e Dosjes së Tenderit.**

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Astrit Mullabazi  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit  
Komuna e Rahovecit